



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:235132

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05618350

**P.nr.781/2023**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në lëndën penale ndaj të pandehurit I... E..., nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e mbron avokat Halit Azemi nga Gjilani, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjilani, PP.II.nr.1396 /2023, të datës 30.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 17.04.2024, publikisht shpalli, ndërsa më 22.04.2024, përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

**Ndaj të pandehurit: I... E**, nga babai B., nëna S.e lindur V., i lindur me 16.01.1986 në Gjilan, me vendbanim në Gjilan rr. "Mustafe Kokaj" nr. 33, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në ...., i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal . shqiptar, shtetas Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### S E P S E

Më datë 30.04.2023, rreth orës 11:30, në Gjilan, në tek stadiumi sintetik i qytetit i pandehuri Irfan Esati me dashje i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore personit tjetër të mitur - të dëmtuarit Aris Maliqi, në atë mënyrë që: i pandehuri pas një kacafytje që po ndodhte në fushën e lojës mes lojtarëve të dy ekipeve, futet në fushën e lojës dhe fillimisht të dëmtuarin e mitur e godet me grusht në anën e majtë të fytyrës e pastaj e kap për qafe duke i shkaktuar kështu lëndime, i cili si rezultat i lëndimeve të pësura ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin e përgjithshëm-Emergjencia në Gjilan.

**Me çka ka kryer veprën penale, lëndimi i lehtë trupor, nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës;**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore si dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,42,43,44,69,70,71,72, si dhe nenit 364 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurin Irfan Esati:

## **E g j y k o n**

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej **njëqind e pesëdhjetë (150) ditësh**, i cili **dënim me pëlqimin e të pandehurit në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, I ZËVËNDSOHET në dënim me gjobë** në shumë prej njëqindë(1500)euro, të cilën shumë duhet ta paguaj ne pestë të barabarta duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**Mirëpo** nëse eventualisht i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së të njëjtit i zëvendësohet me dënim me burgim duke ju llogaritur çdo 20 euro të barabartë me 1 (një) dite burgimi. ose në mënyrë për pjesëtimore me pjesën e dënimit të gjobës së pa paguar, të cilin dënim duhet ta filloj ta mbaj ne afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga gjykata.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasuroro juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej njëzetë (20) euro si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej tridhjetë (30) euro, secila e në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## **A r y e t i m**

### *1. Historiku i procedurës*

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 21.04.2022, ka ngritur aktakuzën e lartcekur, ndaj të pandehurit Irfan Esati, nga

Gjilani, të cilin sipas autorizimit e mbrojnë avokat Halit Azemi nga Gjilani, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së. Në shqyrtimin gjyqësor të datës 17.04.2024, ish-in prezent Prokurorja e Shtetit, i pandehuri . si dhe i dëmtuari .. Në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, deklarohet se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen kësaj vepre penale, ndërsa i dëmtuari Aris Maliqi ka deklaruar se i bashkangjitet ndjekjes penale dhe se mbetet pranë kërkesës pasurore juridike.

## 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit Irfan Esati, për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se e pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht në konsultim me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.. se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike gjithnjë duke u konsultuar me mbrojtësin e tij.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i pandehuri ., nga Gjilani, ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## 4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve dhe të mbrojtësit lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin ..., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha

tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti e ka pranuar edhe vet.

#### 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit me burg, ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit e të pandehurit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 72 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim, se i pandehuri ka bashkëpunuar me prokuroren e shtetit, pranimin e fajësisë e ka bërë në shqyrtim kryesor në konsultim me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Halit Azemi, se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë penale, e se i njëjti ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale, sjellje korrekte gjatë shqyrtimit dhe fakti që nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër penale të kësaj natyre. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese është se i pandehuri pas një kacafytje që po ndodhte në fushën e lojës mes lojtarëve të dy ekipeve, futet në fushën e lojës dhe fillimisht të dëmtuarin e mitur e godet me grusht në anën e majtë të fytyrës e pastaj e kap për qafe duke i shkaktuar kështu lëndime, i cili si rezultat i lëndimeve të pësuar ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin e përgjithshëm-Emergjencja në Gjiilan.

#### 6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me burg, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.Gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim të nenit 368 të KPP-s pas shpalljes së aktgjykimit ka dhënë një arsyetim të shkurtër lidhur me arsyet përmbledhëse për dënimin e shqiptuar dhe qëllimin që ka synim ta arrij tek i akuzuari Irfan Esati duke e disiplinuar të njëjtin por edhe qytetarët potencial që

në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale. Palët janë paralajmëruar për të drejtën në ankesë.

#### 8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke bazuar në nenin 462 të KPP-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

#### 9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin t'a detyrojë për ti paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**Divizioni Penal**  
**P.nr. 781/2023, më 17.04.2024**

Bashkëpunëtore Profesionale

Gjyqtari i vetëm gjykues

Vlora Selmani-Rahimi

Veli Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate